



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:089514  
Datë: 18.06.2024  
Numri i dokumentit: 05828486

C.nr.252/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësit S.M, nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson Av. D.M, nga Prizreni, kundër të paditurës E në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 €, jashtë seance, më 18.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA**

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.M, nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura E me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia kompensojë dëmin material dhe jo material në shumën prej 1,000.00 €, me kamare ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej datës së paraqitjes së padisë (dt.12.04.2023), si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës aq sa do të bëhen.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësi S.M, nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson D.M, Avokat nga Prizreni, kanë ushtruar padi kundër të paditurës E me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit avokati D.M, me parashtrësë të veçantë, e ka njoftuar gjykatën se heqë dorë nga padia dhe kërkesëpadia.

Meqenëse, paditësi ka tërhequr kërkesë-padinë në kuptim të nenit 149.2 të LPK-së, nuk është i nevojshëm pëlqimi i të paditurit, për çka Gjykata në kuptim të nenit 149.1 të LPK-së, pa shqyrtim të mëtejme ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 160.6 të LPK-së, në pjesën arsyetuese të këtij Aktgjykimi, janë dhënë vetëm arsytet që justifikojnë dhënien e tij.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë dhe në bazë të neneve 142, 143, 144, 146, 160 dhe 149 të Ligjit për procedurën kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,  
C.nr.252/2023, më datë 18.06.2024

B. Profesional  
Armond Qmega

Gjyqtari  
Betim Behluli

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit–Divizioni Civil në Prishtinë.